



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr.Prot _____

[Dt. 08.02.2023]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

OPERATORIT EKONOMIK “BNT ELECTRONICS” SHPK

Adresa: Tirane Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Sistemi elektronik për të ruajtur, menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë (letër)” me Nr. reference REF-55522-12-29-2022** për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i kontratës*): Buletini Nr. 179 datë 30 Dhjetor 2022

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i fituesit paraprak*): Buletini Nr. 12 datë 6 Shkurt 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- **Operatori ekonomik “SOFT & SOLUTION” SH.P.K, NIPT L11328009F**

Vlera e ofertës pa tvsh = 29,005,600 (njëzet e nëntë milion e pesë mijë e gjashtëqind lekë) lekë.

- **Operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SH.P.K, NIPT J61817047D**

Vlera e ofertës pa tvsh= 28,780,000 (njëzet e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “SOFT & SOLUTION” SH.P.K, NIPT L11328009F**

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 pika 4 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si vijon:

I. Në pikën 1.a dhe 1.b të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit, AK kërkon:

...“ 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

...”

Operatori Ekonomik “SOFT & SOLUTION” SH.P.K, nuk ka paraqitur asnjë dokument në spe për përmbushjen e pikave 1.a dhe 1.b të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit të Dokumentave Standarde të Tenderit për këtë procedurë prokurimi, objekt vlerësimi.

Referuar faktit se Operatori Ekonomik “SOFT & SOLUTION” SH.P.K nuk plotëson kërkesat bazë të DST sikurse është ai i paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe sigurimit të ofertës, në vijim të arsytimit gjykojmë se gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Soft & Solution” sh.p.k, nuk do të ndryshojë duke u s’kualifikuar nga procedura në fjalë, rrjedhimisht, kriteret e tjera për kualifikim, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“BNT ELECTRONICS shpk**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 28,780,000 (njëzet e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë me adresë Blv “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtwdhjetw) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JOX

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____